



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 13 dhjetor 2013
Nr. ref.:RK516/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI132/13

Parashtrues

Muharrem Shabani

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Trupit gjykues të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, SCEL-09-0001, të 24 shkurtit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Muharrem Shabani nga fshati Bradash, komuna e Podujevës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Vendimin e Trupit gjykues të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Trupi gjykues i Dhomës së Posaçme), SCEL-09-0001, të 24 shkurtit 2011.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është realizimi i së drejtës në një pjesë të 20% nga privatizimi i Ndërmarrjes shoqërore “Ramiz Sadiku” (në tekstin e mëtejme: NSH. “Ramiz Sadiku”), në Prishtinë.

Baza juridike

4. Kërkesa është e bazuar në nenet 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenet 20 dhe 22.7 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 56 paragrafin 2 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 27 gusht 2013, parashtruesi i kërkesës e parashtrroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 3 shtator 2013, Kryetari e caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu si Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.
7. Më 17 shtator 2013, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 21 tetor 2013, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmëri.

Përmbledhja e fakteve

9. Parashtruesi ka qenë në marrëdhënie pune me NSH “Ramiz Sadiku” prej 15 gushtit 1974 deri më 10 korrik 1994.
10. Më 8 mars 1995, Fondi për Sigurim Pensional dhe Invalidor mori vendim me të cilin parashtruesit, për shkak të sëmundjes, iu caktua pensioni invalidor.
11. Më 27 qershor 2006, NSH “Ramiz Sadiku” e përfundoi procesin e privatizimit.
12. Më 27 mars 2009, Agjencia për Privatizim (në tekstin e mëtejme: Agjencia), e publikoi listën përfundimtare të punëtorëve që kishin fituar të drejtën në një pjesë të 20% nga privatizimi NSH “Ramiz Sadiku”.

13. Më 18 shkurt 2010, parashtruesi ushtroi ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, kundër listës përfundimtare, të cilën e kishte përpiluar Agjencia, sepse ai si punëtor i mëparshëm nuk gjendej në listë.
14. Në ankesë, parashtruesi theksoi se për shkak të sëmundjes nuk kishte mundur të paraqesë kundërshtim ndaj listës preliminare.
15. Më 24 shkurt 2011, Trupi gjykues i Dhomës së Posaçme e nxori Vendimin SCEL-09-0001, me të cilin e hodhi poshtë ankesën e parashtruesit si të papranueshme.
16. Në arsyetim të vendimit, Trupi gjykues i Dhomës së Posaçme citoi: *„duke pasur parasysh se ankesa e parashtruesit është pranuar më 18 shkurt 2010, që do të thotë pas kalimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesës, nuk ekziston mundësia e kthimit në gjendje të mëparshme, përkatësisht që ankesa e parashtruesit të shqyrtohet si të ishte ushtruar brenda afatit. Duke pasur parasysh këtë, Trupi gjykues i Dhomës së Posaçme e hedh poshtë ankesën e parashtruesit si të papranueshme“.*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimi i lartpërmendur ia shkel të drejtën e tij të punës dhe të drejtën e dinjitetit njerëzor, sepse ai kishte punuar në ndërmarrjen e lartpërmendur për 20 vite.
18. Parashtruesi i drejtohet Gjykatës Kushtetuese me kërkesën:

„Se ai dëshiron që edhe atij t'i takojë 20% nga privatizimi, në të cilin ai ka të drejtë sipas ligjit në fuqi“.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

19. Për të qenë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata para së gjithash duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
20. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se neni 113.7 i Kushtetutës parasheh:

“7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Për më tepër, edhe neni 47.2 i Ligjit parasheh: *“Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

21. Në këtë drejtim, parimi i subsidiaritetit nënkupton që parashtruesi i kërkesës t'i shterojë të gjitha mundësitë procedurale në procedurë të rregullt për ta

parandaluar shkeljen e Kushtetutës, ose, nëse ka pasur shkelje, për ta korrigjuar shkeljen e tillë të një të drejte themelore të njeriut.

22. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka ushtruar ankesë në Kolegjin e Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, kundër Vendimit të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme, SCEL-09-0001, të 24 shkurtit 2011, në të cilën ankesë ai kishte pasur të drejtë sipas ligjit.
23. Gjykata thekson se neni 10.6 (Aktgjykimet, Aktvendimet dhe Apelet) i Ligjit Nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme përcakton:

“Pala ka të drejtë të apelojë ndaj aktgjykimit apo aktvendimit të gjyqtarit të vetëm, nën-kolegjit apo kolegjit të specializuar – apo ndaj gjykatës që ka kompetencë mbi një kërkesë, lëndë, procedurë apo rast sipas paragrafit 4. të nenit 4 të këtij ligji – tek kolegji i apelit, duke parashtruar apelin tek kolegji i apelit dhe duke dorëzuar atë parashtrësë tek palët tjera brenda njëzetënjë (21) ditësh...”

24. Gjykata dëshiron të theksojë se arsyetimi për kërkesën e shterimit është që t'iu ofrojë autoriteteve përkatëse, duke përfshirë edhe gjykatat, mundësinë për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljet e pretenduara të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjete efektive juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese (shih rastin Selmouni kundër Francës, nr. 25803194, GJEDNJ, vendimi i 28 korrikut 1999).
25. Në këtë drejtim, Gjykata konkludon se parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike që i ka pasur në dispozicion sipas ligjit në fuqi, siç është paraparë me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47.2 të Ligjit.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) a) të Rregullores së punës, më 21 tetor 2013, njëzëri

VENDOS

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtari raportues



Kadri Kryeziu



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani